

UDHËZUES PËR DREJTUESIN

Si ta Përdorim Këtë Studim Bible?

Ky studim Bible u jep drejtuesve mjete të thjeshta për të udhëhequr grupin e tyre përmes një studimi përfshirës dhe ndërveprues të Shkrimeve. Thjeshtësia dhe thellësia e këtyre studimeve inkurajon njerëzit e të gjitha moshave dhe niveleve të besimit të eksplorojnë Shkrimet si në mënyrë individuale ashtu edhe në grupe të vogla.

Studimi shërben si një udhëzues ditor që pjesëmarrësit mund ta plotësojnë vetë duke përdorur një pjesë nga Shkrimet si përgatitje për takimin e grupit apo diskutimin e javës në vijim.

Çdo ditë pjesëtarët lexojnë pjesën e Biblës që u është caktuar, luten për të kuptuar dhe u përgjigjen pyetjeve ditore. Çdo ditë, Fryma e Shenjtë nxjerr në pah kuptim më të thellë dhe shton zbulesa në lidhje me pjesën biblike. Pjesëmarrësit mësojnë të studiojnë në mënyrë vepruese Fjalën e Perëndisë, duke zbuluar dhe zbatuar të vërtetat shndërruese të Perëndisë përmes përdorimit të qasjes së thjeshtë të studimit të Biblës si më poshtë:

- **Vëzhgimit**
Çfarë na thonë Shkrimet?
Cila është idea kryesore?
- **Interpretimit**
Çfarë kuptimi kanë Shkrimet?
Cilat janë fjalët, shprehjet dhe të vërtetat e rëndësishme?
- **Zbatimit**
Si po më drejton Fryma e Shenjtë që ta zbatoj në jetën time këtë Shkrim?

Si të Fillojmë një Grup Studimi Biblik?

Besojmë se Perëndia dëshiron të përdorë atë që ju jeni dhe vendin ku jetoni, punoni apo keni shoqëri për të pasur ndikim në përjetësi. Këta janë tre hapat e thjeshtë për të filluar:

1. LUTUNI

... gjithçka fillon me lutje dhe marrëdhënie.

LUTJE

- Lutuni për një shok/shoqe që t'ju ndihmojë për të filluar grupin e studimit biblik.
- Lutuni rregullisht së bashku. Kërkojini Perëndisë planin dhe drejtimin e Tij.
- Lutuni ndërsa ecni në zonën tuaj. Kërkoni bekimin dhe mbrojtjen e Perëndisë.
- Lutuni për njerëzit duke i përmendur me emër. Kërkojini Perëndisë mundësi për t'i takuar, për t'u kujdesur e për t'u shërbyer atyre. Veprat e përkujdesjes hapin zemrat dhe ndërtojnë marrëdhëniet.
- Lutuni që ata të kenë interes për të studiuar Biblën.

MARRËDHËNIE

- Takoni ata që jetojnë, punojnë apo kanë shoqëri pranë jush. Jini miqësor dhe inkurajues.
- Filloni biseda – bëni pyetje me vend dhe jini dëgjues të mirë.
- Kaloni kohë së bashku, për çaj, kafe ose vakte.
- Kërkoni mundësi për të dashur, dhënë dhe shërbyer.

2. KRIJONI LIDHJE

... gjeni ata që janë të interesuar.

PLANIFIKONI NJË TAKIM

- Zgjidhni datën, orën dhe vendin.
- Rendisni njerëzit që do ftoni.
- Lutuni dhe ftojini.
- Planifikoni pije freskuese, nëse dëshironi.
- Rendisni pyetjet për bisedën ose planifikoni një aktiviteti “prezantimi dhe njohjeje” për takimin.

UDHËZIM PËR TAKIMIN

- Shërbeni kafe, çaj dhe/apo ndopak ushqim të lehtë nëse dëshironi.
- Urojini mirëseardhjen pjesëmarrësve, prezantohuni dhe filloni të njiheni me ta (duke përdorur pyetje apo ndonjë aktivitet) dhe jepuni kohë t'i gëzohen pranisë së njëri-tjetrit.
- Aty nga fundi i pjesës tuaj, thoni diçka, psh: *“Kaluam shumë mirë së bashku. Kam dëshirë të krijoj një mjedis të sigurt dhe një bashkësi përkujdesjeje ku një grup prej nesh mund të studiojnë Biblën së bashku, duke zbuluar atë që thuhet aty dhe se lidhet ajo me ne personalisht. Më thoni ju lutem nëse do ishit të interesuar.”*

3. DREJTONI

... tani filloni.

- Shkarkoni dhe printoni Udhëzuesin e Studimit për çdo person.
- Zgjidhni një nga katër grupet e Shkrimeve të Sugjeruara në atë Udhëzues Studimi.
- Pjesëmarrësve do t'u duhet një fletore e vogël për të shënuar përgjigjet e pyetjeve të përditshme.

Si ta Drejtojmë Grupin e Studimit Biblik?

Filloni me një lutje të shkurtër.

- Lexoni historinë hyrëse të BESIMIT që gjendet më poshtë e që shpjegon temën e studimit.
- Kërkojini dikujt të lexojë me dëshirën e vet Shkrimet.
- Drejtoni diskutimin duke ndjekur pyetjet e përditshme në Udhëzimin e Studimit.
- Mos kini frikë nga qetësia që krijohet para dhënies së përgjigjeve. Qëllimi është të diskutohet, jo t'u jepet përgjigje të gjitha pyetjeve nga drejtuesi.

Është e rëndësishme që për të siguruar diskutim frytdhënës t'i kujtohen grupit rregullisht disa udhëzime të dobishme:

- Flisni me zë të lartë që të dëgjoheni nga të gjithë.
- Jepni përgjigje me pohime të shkurtra, jo histori të gjata.
- Mbajeni diskutimin me në qendër Krishtin dhe Biblën.
- Rrini të përqëndruar dhe shmangni çështjet kontradiktore.

Sigurojeni grupin tuaj se Fryma e Shenjtë do marrë Fjalën e Tij, rrethanat e jetës së çdo pjesëmarrësi, vendndodhjen e tyre në rrugëtimin frymor, dhe do t'i mësojë ata personalisht se çfarë Ai dëshiron që ata të dinë e të zbatojnë në jetët e tyre.

- Në fund të çdo seance studimi, caktoni Shkrimet për javën në vijim.
- Inkurajojeni grupin të ftojë të tjerë të bëhen pjesë e studimit në çdo kohë. Kjo krijon një mjedis inkurajues dhe një bashkësi përkujdesëse.
- Mbylleni takimin me një lutje të shkurtër.

Pyetje të tjera shtesë për të përforcuar studimin tuaj:

- Çfarë gjëje tjetër të mësoi Perëndia?
- A mund ta shpjegoni përgjigjen tuaj në mënyrë më të plotë?
- Çfarë tjetër do donte ndonjëri t'i shtonte kësaj përgjigjeje?
- Çfarë ju bëri më shumë përshtypje nga ky varg?

Hyrje:

Ky studim biblik mbi besimin rrjedh nga pohimi: “Duke besuar plotësisht në atë që Perëndia thotë, zgjedh të jetoj me anë të besimit duke dorëzuar zemrën time.” Perëndia i krijoi zogjtë të enden anembanë dhe jo të rrinë ngjitur në fole. Që prej lindjes zogu mëmë i ushqen dhe mbron të vegjëlit e saj e më pas i mëson ata të fluturojnë. Si mund t'i duket një zogu të vogël të kapërcejë jashtë folesë së tij me besim e të përjetojë të vërtetën për gjithçka që zogu mëmë i ka mësuar dhe treguar me shembullin e saj? A mund t'i përfytyroni zogjtë të zgjedhin të jetojnë gjithë jetën brenda folesë ndërkohë që janë në gjendje të fluturojnë?

Perëndia dëshiron që besimtarët të ngjiten lart në fluturim mbi krahë besimi. Bibla është libri udhërrëfyes, personazhet e saj janë shembujt dhe Fryma e Shenjtë është mësuesi i kësaj jete me besim. Bibla është e mbushur me historitë e atyre që zgjedhën një jetë moskokëçarjeje dhe mosbindjeje, si dhe të atyre që u ngjitën lart në fluturim mbi krahët e një besimi të mahnitshëm. Ajo na jep udhëzime të qarta se si duhet jetuar me besim ndërkohë që Fryma e

Shenjtë i nxit dhe i fuqizon besimtarët të marrin krahë. Pyetja së cilës i duhet dhënë përgjigje çdo javë është: “Do zgjidhni të rrini ngjitur në fole apo do ngjiteni lart në fluturim?”

Besimi do t’ju mësojë, ndërtojë dhe inkurajojë se si të vini në provë krahët tuaj. Këto katër studime tetë-javore do t’ju japin një perceptim të thellë të disa personazheve biblikë si dhe të mësimëve të Jezusit dhe Palit. Mësoni si të ngriheni lart duke lexuar pjesë të shkëputura nga librat e Gjyqtarëve, I Samuelit, I & II Mbretërve, Veprave, Ungjillit sipas Gjonit dhe Romakëve.

